



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1030 Prot.

Tiranë, më 17 / 07 / 2020

V E N D I M

Nr. 74 , Datë 17 / 07 / 2020

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën me nr.14, datë 15.02.2019 të Qendrës “Konsumatori Shqiptar” kundër Ministrisë së Mbrojtjes (MM) dhe Institutit të Sigurimeve Shoqërore (ISSH), me pretendimin për diskriminim për shkak të “përkatësisë në një grup të veçantë¹”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi²,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Problematika e parashtruar në ankesën e sjellë nga subjekti ankues, Qendra “Konsumatori Shqiptar”, konsiston në sa më poshtë citohet:

Ligji nr.9128, datë 23.07.2003 “Për një trajtim të veçantë financiar të pilotëve fluturues në pension” rregullon të drejtën për pension të pilotëve fluturues që kanë fluturuar me avionë reaktiv dhe me avionë me helikë, duke përcaktuar dhe kushtet dhe kriteret për trajtimin e veçantë të kësaj kategorie.

¹ Referimin tek ky shkak, subjekti ankues e justifikon me pwrkatwsinw e subjekteve tw cilwt pwrfaqwsojnw nw kategorinw e pilotwve qw kanw fluturuar me helikopterwt e Ushtrisw Mi-4.

²Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën KMD.

Ky ligj është ndryshuar me ligjin nr.10 135, datë 2009 dhe Ligjin nr.10 353, datë 18.11.2010, duke zgjeruar dhe shtuar kategorinë e pilotëve përfutues, respektivisht: pilotët/teknikët e Ministrisë së Shëndetësisë, të Policisë së Shtetit dhe të Gardës së Republikës.

Qendra “Konsumatori Shqiptar” ka parashtruar se këto amendime të ligjit parashikuan pagën e grupit plus pozicionin dhe shtesat për fluturime për pilotët e mjekësisë, për pilotët e Policisë së Shtetit-shtesë për natyrë të veçantë pune e shërbimi, për pilotët e Gardës së Republikës-plus shtesën për kushte të veçanta shërbimi.

Ndërsa, për pilotët e helikopterit Mi-4, këto ndryshime të ligjit nuk ndikuan në përmirësimin dhe shtimin e pensionit të kësaj kategorie. Mbështetur në aktet e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, qëllimi i këtyre ndryshimeve ka qenë përfshirja e këtyre kategorive, për shkak të veprimtarisë së vështirë dhe punës së tyre. Përfitimi financiar i këtyre kategorive është i ndryshëm, megjithëse sistemi i përlllogaritjes së pensionit është i njëjtë.

Pilotët që kanë fluturuar me helikopterët e Ushtrisë Mi-4 (helikopterë të mesëm, nga viti 1964 deri në vitin 2004, pothuajse 40 vjet përdorim, me vështirësi dhe rrezikshmëri të lartë, me zhurma e vibrime në kufijtë kritikë, referuar mjeteve të fluturimit) kanë kryer detyra në ndihmë të Ushtrisë si Rezervë e Komandës së Përgjithshme, për transportim shtabesh, transportim të kufizuar trupash, desantë, korrierë të Postës Ushtarake, transport municioni, transport të plagosurish etj. Kanë marrë pjesë në stërvitjet e përbashkëta me ushtritë aleate dhe në shërbim të SAR. Në shkresën e Qendrës “Konsumatori Shqiptar” evidentohet se:

- Në ndihmë të Ministrisë së Shëndetësisë (deri në vitin 1995) kanë mbuluar të gjitha nevojat e transportit me helikopter Mi-4, për të sjellë në Tiranë të gjithë ata që kanë patur nevojë për ndihmë të kualifikuar mjekësore, në raste aksidentesh automobilistike, për transport të ekipeve mjekësore, për shpëtimin e njerëzve gjatë përmbajtjeve etj.
- Në ndihmë të ekonomisë kombëtare kanë realizuar: Transport të transformatorëve të ekipeve për dëmtimet e linjave të tensionit të lartë, për kontrollin e digave të H/C, për shpëtim në miniera, në raste zjarresh, në rast të bllokimit të rrugëve nga dëborat duke ndihmuar në furnizimin me produkte ushqimore e veshmbathje popullatën e izoluar etj.
- Gjatë krizës kosovare kanë transportuar të plagosur të UÇK nga veriu në spitalet e Tiranës, transport të figurave të shquara dhe të njohura nga Kosova nëpër kampingje, transport gazetarësh e kronistësh, transport medikamentesh e ndihma ushqimore, veshmbathje, të sëmurë etj. Në konkluzion të sa mësipër, theksohet fakti që ata kanë qenë në gadishmëri 24 orë, ditën dhe natën gjatë gjithë karrierës së tyre ushtarake.

Qendra “Konsumatori Shqiptar” citon se: *“Mbështetur në situatën aktuale mbi masën e pensionit të këtyre kategorive, që përfitojnë trajtim të veçantë, mendojmë që pilotët fluturues që kanë fluturuar me avionë reaktivë e me avionë me helikë Mi-4, në Farkë, Tiranë, kanë një trajtim jo të barabartë me kategoritë e tjera të rregulluara në amendimet e mëvonshme të ligjit nr.9128, datë 29.07.2003 “Për një trajtim të veçantë financiar të pilotëve fluturues në pension”. Masa më e vogël e pensionit të kësaj kategorie, pavarësisht nivelit të vështirësisë në punë, krahasuar me kolegët e tyre që kanë fluturuar për llogari të institucioneve të tjera, i vendos këta pilotë në pozita*

të pabarabarta dhe diskriminuese. Pilotët fluturues që kanë fluturuar me avionë reaktivë dhe me helikë Mi-4, në Farkë, Tiranë, ndjehen të diskriminuar në raport me kolegët e tyre, përfitimi i të cilëve bazohet në amendimet e ligjit sipërcituar. Trajtimi i tyre i pabarabartë financiar i vë ata në pozita diskriminuese”

Në përfundim të ankesës së tyre, subjekti ankues ka kërkuar që pilotët e helikopterit Mi-4 të ketë të njëjtin trajtim me kategoritë e tjera të pilotëve përfitues, parashikuar në ligjin nr.9128, datë 23.07.2003 “Për një trajtim të veçantë financiar të pilotëve fluturues në pension”, të ndryshuar.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10 221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 7 i LMD-së³, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10 221/2010, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën me nr.258/1 prot., datë 16.05.2019 i është kërkuar informacion subjekteve kundër të cilëve është paraqitur ankesa, lidhur me pretendimin e subjektit ankues.

³Shkurtesë për Ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi.

Adresa: Rruga e Durrësit, Kodi postar 1001, (Ish-Ministria e Mjedisit), Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: info@kmd.al, web: www.kmd.al

- ISSH, nëpërmjet shkresës me nr.3731/1 prot., datë 29.05.2019 informon Komisionerin si më poshtë citojmë:

“Ligji nr. 9128, datë 23.07.2003 “Për një trajtim të veçantë financiar të pilotëve fluturues në pension”, i ndryshuar, në nenin 2 dhe 3 të tij “Baza e llogaritjes” ka përcaktuar se: “Paga referuese është bazë për llogaritjen e këtij trajtimi financiar të veçantë. Pagimi dhe caktimi i përfitimeve që rrjedhin nga ky ligj bëhet nga ISSH. Mënyra e llogaritjes së përfitimeve që rrjedhin nga ky ligj miratohet nga Këshilli i Ministrave”.

Aktet nënligjore në zbatim të këtij Ligji, kanë përcaktuar dhe procedurat e lëvizjes së dokumentacionit dhe ISSH cakton trajtim të veçantë financiar, vetëm mbi bazën e dokumentacionit të dërguar nga strukturat përkatëse të cilat janë: “Vërtetim për pagën referuese” dhe “Vërtetim për vite shërbimi”.

Numri në total i pilotëve që trajtohen me ligjin nr. 9128, datë 23.07.2003 “Për një trajtim të veçantë financiar të pilotëve fluturues në pension”, i ndryshuar, është 237 përfitues në total dhe kategoritë përfituese janë:

- *Pilotët të cilët kanë fluturuar me avionë reaktivë e me avionë me helikë;*
- *Pilotët/technikët e Forcave të Armatosura, të cilët kanë fluturuar me helikopterë;*
- *Pilotët/technikët e Njësisë së Transportit Mjekësor me Helikopter, të cilët kanë fluturuar me helikopterë;*
- *Pilotët/technikët e Repartit të Helikopterëve të Policisë së Shtetit, të cilët kanë fluturuar me helikopterë;*
- *Pilotët/technikët e Gardës së Republikës, të cilët kanë fluturuar me helikopterë.*

Mënyra e e përlllogaritjes së trajtimit të veçantë financiar është përcaktuar në nenin 4 dhe 5 të këtij Ligji, të ndryshuar. Llogaritja e trajtimit të veçantë financiar varet nga paga referuese dhe vjetërsia në shërbim, të cilat janë individuale për secilin përfitues. Përfitimet specifike/financiare për secilën kategori janë dhënia e trajtimit të veçantë financiar në shtesë të pensionit të pleqërisë, të cilin e përfitojnë nga sigurimi shoqëror i detyrueshëm, në momentin e lindjes së përfitimit të këtij trajtimi”.

- MM, nëpërmjet shkresës me nr.3224/3 prot., datë 06.06.2019 ka parashtruar si më poshtë:

“Në mbështetje të nenit 2, të ligjit nr. 9128, datë 23.07.2003 “Për një trajtim të veçantë financiar të pilotëve fluturues në pension”, të ndryshuar dhe VKM nr.53, datë 29.01.2004 “Për procedurat dhe masën e trajtimit të veçantë financiar të pilotëve fluturues në pension”, për llogaritjen e trajtimit financiar merret si bazë paga referuese, e cila përbëhet nga paga bazë për funksionin plus shërbimin për gradë, të njësuar me pagën referuese të funksionit të ushtarakut aktiv, në të njëjtën detyrë me përfituesin, në çastin e lindjes të së drejtës për këtë trajtim financiar.

Paga bazë për funksionin përfshin:

- a) *Pagën bazë për klasën e funksionit organik;*
- b) *Shtesat për vjetërsi;*
- c) *Shtesat për vështirësi vendi e shërbimi;*

Paga referuese për përfituesin, të cilit i lind e drejta nga data 1 Janar 2004, përfshin:

- a) *Pagën bazë për gradë;*

- b) Shtesën për natyrë të veçantë;
- c) Shtesën për dëmshmëri shëndeti;
- d) Shtesën për ruajtje page.

Përfitimet financiare për secilën kategori përfituese të përcaktuar në këtë Ligj, bëhen në mbështetje të nenit 4 të tij, duke përcaktuar se: “Pilotët, të cilët kanë fluturuar me avionë reaktivë, avionë me helikë dhe helikopterë dhe që kanë plotësuar ose plotësojnë kushtet për pension pleqërie, përfitojnë, përveç pensionit të pleqërisë, një trajtim të veçantë financiar, në shtesë të pensionit në masën:

1. 50% të pagës referuese që ka pasur përfituesi në çastin e daljes në rezervë, lirim ose pension pleqërie:
 - a) Kur piloti ka fluturuar me avionë reaktivë, jo më pak se 12.5 (dymbëdhjetë vjet e gjashtë muaj) vite kalendarike;
 - b) Kur piloti ka fluturuar me avionë me helikë dhe me helikopterë, jo më pak se 16.5 (gjashtëmbëdhjetë vjet e gjashtë muaj) vite kalendarike.
2. 35% të pagës referuese që ka pasur përfituesi në çastin e daljes në rezervë, lirim ose pension pleqërie:
 - a) Kur piloti ka fluturuar me avionë reaktivë, jo më pak se 8.5 (tetë vite e gjashtë muaj) vite kalendarike;
 - b) Kur piloti ka fluturuar me avionë me helikë dhe me helikopterë, jo më pak se 12.5 (dymbëdhjetë vjet e gjashtë muaj) vite kalendarike.
3. 25% të pagës referuese që ka pasur përfituesi në çastin e daljes në rezervë, lirim ose pension pleqërie, për funksionet avion drejtues fluturues, qitës-radist, radist, teknik, fluturues bordi, me jo më pak se 15 vite vjetërsi në shrbim, pavarësisht nga koha e daljes në pension.

Shuma e pensionit të plotë të pleqërisë, plus masa e trajtimit të veçantë financiar, sipas këtij ligji, nuk mund të jetë më e madhe se 50% e pagës referuese të pilotit fluturues, kur ka dalë në rezervë, lirim ose pension pleqërie”.

Në vijim, nëpërmjet e-mailit⁴ të datës 14.07.2020, Drejtorja Ekzekutive e Qendrës “Konsumatori Shqiptar” ka informuar Komisionerin se për arsye objektive kërkon të tërhiqet nga shqyrtimi i ankesës së sjellë pranë KMD-së.

⁴ Adresa e e-mailit të Qendrës “Konsumatori Shqiptar”: gendrakonsumatorishqiptar@gmail.com.

Adresa: Rruga e Durrësit, Kodi postar 1001, (Ish-Ministria e Mjedisit), Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: info@kmd.al, web: www.kmd.al

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), c), si dhe nenin 33, pikat 9, 10, të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, si dhe nenin 94, pika 1⁵ e Kodit të Procedurës Administrative,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Ndërprerjen e procedurave hetimore dhe pushimin e shqyrtimit të ankesës së Qendrës “Konsumatori Shqiptar”, pasi subjekti ankues është tërhequr nga pretendimi për të cilin kishte filluar procedura hetimore.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONER

Robert GAJDA

Punoi: R.Hoxha
Sigloi: V.Bushati
Datë: 15.07.2020

⁵ “Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj, pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë”.

Adresa: Rruga e Durrësit, Kodi postar 1001, (Ish-Ministria e Mjedisit), Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: info@kmd.al, web: www.kmd.al